

**Prot. 2211/221 K (e-k)**

**Datë, 22/11/2022, Tiranë**

**Lënda:** Partia Agrare Ambientaliste

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin PAA, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet një numër prej 3 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*

- *1 kandidat ka deklaruar pranimin e dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*

- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*

- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

### **Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore**

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezultojnë 3 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezultojnë 0 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe fotot përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
41.3163556, 19.4511159	Durrës	PAA - Partia Agrare Ambientaliste		<a href="https://drive.google.com/file/d/1bUEo2qK0kiD1eqoIA0H0HERSUugv6BFR/view?usp=share_link">https://drive.google.com/file/d/1bUEo2qK0kiD1eqoIA0H0HERSUugv6BFR/view?usp=share_link</a>
41.509848, 19.793258	Krujë	PAA - Partia Agrare Ambientaliste		<a href="https://drive.google.com/file/d/17hFLk1jaLR2vbDztX6U1QIKmG9ftr-t/view?usp=share_link">https://drive.google.com/file/d/17hFLk1jaLR2vbDztX6U1QIKmG9ftr-t/view?usp=share_link</a>
41.3162879, 19.4504033	Durrës	PAA - Partia Agrare Ambientaliste		<a href="https://drive.google.com/file/d/1NF-vEeeOp7AVftYf5IDfBRvYRGsbxvEuf/view?usp=share_link">https://drive.google.com/file/d/1NF-vEeeOp7AVftYf5IDfBRvYRGsbxvEuf/view?usp=share_link</a>

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

## **Lidhur me pranime të dhurimeve mbi 50.000 lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare**

Në raportin e vetëdeklarimit rezulton se kandidati i PAA, z. Agron Duka ka marrë cash shumë prej 140.000 lekë (e ndarë në dy këste).

## **Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të PAA për reklamë politike në Facebook dhe Instagram**

Kandidati i PAA, z. Arben Tafaj për faqen në *Facebook* të të cilit është paguar shuma 13.423 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

## **Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve**

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se PAA nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

**Me konsideratë,**

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania